
RREGULLORE E BRENDSHIME

e

Sherbimit te Permbarimit
Gjyqesor

DREJTORIA E PERGJITHSHIME

E

PERMBARIMIT

KAPITULLI I

OBJEKTI I VEPRIMARISE TE SHERBIMIT PERMBARIMOR

Neni 1

Rregullorja e brendshme e Sherbimit Permarimor Gjyqesor, koordinon marrdheniet qe krijohen ne dy shkallet e organizimit, qendror dhe lokal, bazuar kjo ne strukturen organike te ketij sherbimi.

Neni 2

Rregullat e parashikuara ne kete rregullore jane te detyrueshme per zbatim nga te gjitha strukturat organike te Sherbimit Permbarimor Gjyqesor.

Neni 3

Drejtoria e Pergjithshme ne nivel qendror dhe zyrat permbarimore te organizuara ne nivel vendor jane persona juridik, dhe si te tille veprojne ne menyre unike dhe te centralizuar ne varesi te Ministrit te Drejtesise.

KAPITULL II

DREJTORIA DHE DREJTORI I PERGJITHSHEM I SHERBIMIT PERMBARIMOR GJYQESOR

Neni 4

Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor eshte person juridik, i cili zoteron vulen e vet si dhe buxhetin perkates te pavarur nga buxheti i Sherbimit te Permbarimit Gjyqesor.

Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit te Permbarimit Gjyqesor ushtron vetem kompetenca administrative, te ndara nga ato proceduriale ekzekutuese. Ekzekutimi i titujve ekzekutive kerkohet te kryhet vetem prane Zyrove Permbarimore dhe kete atribut e ushtrojne vetem permbaruesit gjyqesor.

Neni 5

Çdo akt administrative i Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit, permban detyrimisht firmen e titullarit dhe vulen e ketij institucioni.

